

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7110
E martë, 6 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

Hovenieri insiston në shtyrjen e zbatimit të rregultores së BQK-së



FACE 3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRI GJERMAN I MBROJTJES NË PRISHTINË: BËJMË THIRRJE PËR MATURI DHE KUJDES

FACE 4-5



Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, po qëndron në Kosovë për vizitë zyrtare. Pas një takimi që ka pasur të hënën me presidenten Vjosa Osmani, ai ka premtuar mbështetje për Kosovën në rrugën evropiane, ndërkaq ka theksuar se

nevojitet përparim i dukshëm në marrëdhëniet Kosovë - Serbi. Pistorius gjatë konferencës së përbashkët për medie me Osmani, ka theksuar se Gjermania, pas ShBA-së, është një nga mbështetëset më të mëdha të

Kosovës si nga aspekti civil, po ashtu edhe ushtarak. "Ne, marrë parasysh tensionet aktuale me Serbinë, dhe pakicën serbe në Kosovë, bëjmë thirrje të qartë për maturi dhe kujdes", ka theksuar Pistorius

AKTUALE



ÇFARË BËJNË TRUPAT AMERIKANE NË LINDJEN E MESME DHE KU JANË ATO? F. 2

KONJUFCA NË ESTONI: ALEANCA E VENDEVE DEMOKRATIKE ËSHTË PËRÇJIGJJA E VETME NDAJ KËRCËNIMIT RUS F. 6

UP-ja UA HAP DYERT STUDENTËVE NDERKOMBËTARË PËR PUNË PRAKTIKE F. 7

EKONOMI



REAGIMI I KMDLNJ-SË PËR FATURAT E RRYMËS

A KA HUMBUR BESIMI NË INSTITUCIONE APO QYTETARËT JANË JASHTË MUNDËSIVE T'I REALIZOJNË TË DREJTAT E TYRE? F. 8

MINISTRIA E BUJQËSISË KTHEN NË PRONËSI PRONËN NË VLERË PREJ 4 MILIONË EUROSH, NË VITIN 2021 I ISHTE DHËNË NJË SERBI F. 8

SPORT



BERISHA PARAQITET TE PETROLUL PLOIESTI; GRIPSHI, AFËR MARRËVESHJES ME CRACOVIAN F. 10

MYRVETE DRESHAJ DHE HAVE SHALA, VAJZAT E PARA QË U ULËN KRAHAS BURRAVE NË ODËN SHQIPTARE PËR PAJTIMIN E GJAQEVE F. 6-7

Hyrja e Myrvete Dreshajt dhe Have Shalës në odën e burrave, ku po mbahej e pamja për dëshmorin Gani Dacin, shënon hyrjen e parë të vajzës/gruas shqiptare në odën shqiptare, në këtë rast në funksion të pajtimit të gjaqeve, e dedikuar, sipas traditës dhe mentalitetit patriarkal, kryesisht për burra

Lulëzim ETEMAJ



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Çfarë bëjnë trupat amerikane në Lindjen e Mesme dhe ku janë ato?

UASHINGTON, 5 SHKURT - Shtetet e Bashkuara filluan sulmet ajrore ndaj objektivave irakiane dhe siriane të lidhura me Gardën Revolucionare të Iranit dhe milicite që mbështet Teherani, pas një sulmi në një nga shumë vendet në Lindjen e Mesme ku ShBA-ja ka prani ushtarake.

Ku janë bazat e ShBA-së në Lindjen e Mesme?

ShBA-ja ka baza në Lindjen e Mesme prej dekadash. Kulmi i pranisë ushtarake të ShBA-së ishte më 2011 me më shumë se 100 000 trupa amerikane në Afganistan dhe mbi 160 000 në Irak më 2007.

Ndërsa numri është shumë më i ulët pas tërheqjes nga Afganistani në vitin 2021, rreth 30 000 trupa amerikane janë ende të shpërndara në të gjithë rajonin. Përveç kësaj, që nga fillimi i luftës Izrael - Hamas në tetor, ShBA-ja ka dërguar përkohësisht mijëra trupa shtesë në rajon, duke përfshirë edhe anijet luftarake.

Baza më e madhe e ShBA-së në Lindjen e Mesme ndodhet në Katar, e njohur si Baza Ajrore Al Udeid dhe e ndërtuar në vitin 1996. Vende të tjera ku ShBA-ja ka prani ushtarake përfshijnë Bahrejin, Kuvajtin, Arabinë Saudite dhe Emiratat e Bashkuara Arabe (EBA).

ShBA-ja ka afërsisht 900 trupa në Siri, në baza të vogla si fusha e naftës al Omar dhe al-Shaddadi kryesisht në verilindje të vendit.



Ekziston një post i vogël pranë kufirit të qarkut me Irakun dhe Jordaninë, i njohur si garnizoni Al Tanf.

Në Irak ka një personel prej 2 500 vetash të shpërndarë rreth objekteve si Union III dhe baza ajrore Ain al-Asad, megjithëse bisedimet janë duke vazhduar për të ardhmen e këtyre trupave.

Pse janë vendosur trupat e ShBA-së në rajon?

Trupat amerikane janë të vendosura në Lindjen e Mesme për arsye të ndryshme dhe me përzjashtim të Sirisë, ato janë atje me lejen e qeverisë së secilit vend.

Në disa vende si Iraku dhe Siria, trupat amerikane janë atje për të luftuar kundër militantëve të Shtetit Islamik dhe po ndihmojnë, gjithashtu, në këshillimin e forcave lokale. Përgjatë viteve të fundit, ata janë sulmuar nga forcat e mbështetura nga Irani dhe kanë ndërmarrë veprime kundër tyre.

Jordania, një aleat kyç i ShBA-së në rajon, ka qindra trajnues amerikanë dhe ata mbajnë stërvitje masive gjatë gjithë vitit. Në raste të tjera, si në Katar dhe Emiratat e Bashkuara Arabe, prania e trupave amerikane ka për qëllim sigurinë e aleatëve, kryerjen e stërvitjeve dhe përdoren sipas nevojës në operacionet në rajon.

Ndërsa aleatët e Uashingtonit ndonjëherë dërgojnë trupat e tyre për t'i trajnuar ose punuar me trupat amerikane, nuk ka bazë ushtarake të huaj brenda ShBA-së.

Kulla 22 në Jordani

Kulla 22, një bazë në Jordani në pikën më verilindore ku kufijtë e vendit takohen me Sirinë dhe Irakun, u godit në një sulm me dron më 28 janar që vrau tre ushtarë rezervë të ushtrisë. Uashingtoni fajësoi milicinë irakiane Kataib Hezbollah të mbështetur nga Irani. Konkretisht, Kulla 22 është afër garnizonit Al Tanf, i cili ndodhet

përtej kufirit në Siri, dhe ku strehohet një numër i vogël i trupave amerikane. Duke qenë kyç në luftën kundër Shtetit Islamik, Tanf ka marrë një rol si pjesë e një strategjie të ShBA-së për ta frenuar ngritjen ushtarake të Iranit në Sirinë lindore.

A sulmohen shpesh bazat e ShBA-së në rajon?

Bazat e ShBA-së janë objekte shumë të mbrojtura, duke përfshirë sistemet e mbrojtjes ajrore për t'u mbrojtur nga raketat ose dronët. Objektet në vende si Katar, Bahreini, Arabia Saudite, Kuvajti zakonisht nuk sulmohen. Por, trupat amerikane në Irak dhe Siri janë sulmuar shpesh vitet e fundit. Që nga 7 tetori, trupat amerikane janë sulmuar më shumë se 160 herë nga milicia e mbështetur nga Irani, duke plagosur rreth 80 trupa, madje edhe para sulmit të së dielës në Kullën 22, i cili plagosi rreth 40 të tjerë.

Një valë e re dhune në Lindjen e Mesme shpërtheu pas 7 tetorit kur luftëtarët palestinezë islamikë të Hamasit hynë në Izrael dhe vranë 1 200 izraelitë dhe morën peng 253 të tjerë. Si përgjigje, Izraeli nisi një fushatë ushtarake, në të cilën deri tash janë vrarë më shumë se 27 000 njerëz, sipas autoriteteve shëndetësore të Gazës, dhe ka shkaktuar një krizë të rëndë humanitare në Rripin e Gazës me popullsi të dendur.

Blinken në Lindjen e Mesme për një armëpushim të ri në Gazë

UASHINGTON, 5 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, është nisur për në Lindjen e Mesme më 5 shkurt në përpjekje për të arritur një marrëveshje të re të armëpushimit në luftën në mes të Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Në turneun e tij të pestë në rajon që kur Hamasi kreu sulmin e 7 tetorit ndaj Izraelit, sulm që nxiti luftën, Blinkeni pritet t'i vizitojë Arabinë Saudite, Izraelin, Egjiptin dhe Katarin.

Para këtij udhëtimi, kryediplomati amerikan theksoi nevojën "për adresimin urgjent të kërkesave humanitare në Gazë", pasi grupet e ndihmës vazhdimisht kanë ngritur alarmin për ndikimin shkatërrues të luftës pothuajse katërmujore në territorin e rrethuar. "Situata është e papërshkrueshme", tha Said

Hamouda, palestinez që ka ikur nga shtëpia e tij dhe është zhvendosur në Rafah, qytet në kufi me Egjiptin.

Sipas Kombeve të Bashkuara, në Rafah tani gjendet mbi gjysma e popullsisë së Gazës prej 2.3 milionë banorësh për shkak të sulmit të Izraelit.

Gjatë fundjavës Izraeli ka vazhduar ofensivën e tij në jug të Gazës, duke paralajmëruar se forcat tokësore mund të përparojnë drejt qytetit Rafah, si pjesë e fushatës së tyre për ta zhdukur Hamasin.

Teksa lufta po vazhdon, Blinkeni pritet të diskutojë për një armëpushim të propozuar gjatë një takimi në janar në Paris mes zyrtarëve të lartë të ShBA-së, Izraelit, Egjiptit dhe Katarit.

Përpjekja diplomatike është bërë edhe më e urgjente pasi në mbarë rajonin janë rritur sulmet nga grupet e mbështetura nga Irani në



solidaritë me Hamasin, sulme që kanë nxitur ShBA-në të përgjigjet me kundërsulme.

Armëpushimi i propozuar parasheh një pauzë të luftimeve fillimisht për gjashtë javë që

Hamasi të lirojë pengje në këmbim të të burgosurve palestinezë që mbahen nga Izraeli.

Serbët e zhvendosur bllokuan kalimin në Rudar për një orë

PRISHTINË, 5 SHKURT - Serbët e zhvendosur nga Kosova të hënën vendosën një bllokadë në Rudar, në jug të Serbisë, pranë pikës kufitare me Kosovën, Merdar. Trafiku u pengua nga një kamion që bllokoi rrugën për rreth një orë, nga mesdita.

Kosova. Komunikacioni u bllokua për të gjitha veturat, ndonëse fillimisht ishte paralajmëruar se nga ora 12:00 deri në orën 15:00 do të pengohej kalimi i veturave që drejtoheshin nga shqiptarë të Kosovës.

thirrje udhëtarëve që, për shkak të bllokimit të rrugës, t'i përdorin pikëkalimet e tjera kufitare për qarkullim. Në Kosovë sërish janë ngritur tensionet pas vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës që nga 1 shkurti valutë e vetme për transaksionet e pagesave do të jetë euro, që nënkupton heqjen e dinarit serb.



Konjufca në Estoni: Aleanca e vendeve demokratike është përgjigjja e vetme ndaj kërcënimit rus

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka nisur të hënën vizitën në Estoni. Ai fillimisht ka takuar homologun estonez Lauri Hussar. Konjufca ka treguar se me Estoninë ndajnë partneritetin strategjik, interesat e përbashkët në shumë sfera, bashkëpunimin e vazhdueshëm, si dhe vlerat e aspiratat e demokracisë. "Po ashtu, i tregova mirënjohjen tonë për mbështetjen që Estonia i ka ofruar Republikës së Kosovës në aspektin ndërkombëtar dhe sfidat rajonale. Z. Hussar më konfirmoi se mbështetja e shtetit estonez do të vazhdojë, e së bashku u pajtuam për nevojën e thellimit të mëtejshëm të raporteve tona, përmes shkëmbimit të përvojave parlamentare, investimeve ekonomike, angazhimit për transformime digjitale, bashkëpunimit në lidhje me sfidat

e sigurisë dhe në çdo fushë të interesit të përbashkët", ka shkruar Konjufca në "Facebook". Ai ka treguar se me Hussarin kanë biseduar edhe për situatën politike të dy vendeve, duke theksuar se, përveç interesave, ndajnë edhe rrezikun e një Rusie në kërkim të destabilitetit. "Aleanca e vendeve demokratike është përgjigjja e vetme ndaj kërcënimit rus, aleatëve dhe satelitëve të saj, ndërsa vendosmëria jonë në vlerat e demokracisë është garancia e palëkundur e të ardhmes së përbashkët të paqes dhe përparimit", ka deklaruar Konjufca.

Në vazhde të vizitës zyrtare në Estoni, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, u prit në takim nga presidenti i Republikës së Estonisë, Alar Karis. "Presidentin estonez e falënderova për pritjen e ngrohtë dhe i tregova mirënjohje për mbështetjen që shteti estonez ka treguar ndaj Republikës së



Kosovës, synimeve tona për integrim në strukturat evropiane apo ndërkombëtare. Diskutuam për bashkëpunimin e deritanishëm mes nesh, duke ndaluar te nevoja e shqyrtimit të mundësive për të forcuar edhe më tutje raportet mes vendeve tona që ndajnë interesa, vlera dhe qëllime të përbashkët", është

shprehur Konjufca. Konjufca ka theksuar se Alan Karis e ka njoftuar me situatën politike në Kosovë. "Vlen të theksohet se ne mbetemi maksimalisht të përkushtuar ndaj sigurisë, posaçërisht pas sulmit terrorist në Banjaskë, me vetëdijen e plotë të rrezikut që influenca ruse në Serbi përbën për rajonin tonë dhe më

gjerë. Angazhimi për paqen, në kohë si këto, konfirmohet nga gatishmëria për të mbrojtur vlerat tona po aq sa edhe territoret tona, me çdo kusht e me të gjitha mjetet e nevojshme. Kjo është ajo që mbi të gjitha duhet të na sjellë çdo herë e më pranë, gjithnjë e më shumë", ka shkruar Konjufca në "Facebook".

Policia në Shqipëri arreston tre kosovarë, iu gjen sasi eksplozivi



PRISHTINË, 5 SHKURT - Policia në Shqipëri ka sekuestruar 46 kilogramë lëndë eksplozive që vinte nga Kosova dhe ka arrestuar tre të rinj nga Gjilani. Drejtori i Policisë së Tiranës, Tonin Vocaj, tha se një grup kriminal nga Kosova ka kryer trafikim armësh dhe lëndësh eksplozive nga Kosova në drejtim të Shqipërisë. "Gjatë një operacioni policor, më 4 shkurt, në afërsi të urës së Gjolës në Fushë-Krujë, u bë arrestimi në flagrancë i

shtetasve kosovarë: Rigon Maliqi, 20 vjeç, Lion Pira, 25 vjeç dhe Shkëlqim Halabaku, 27 vjeç, të tre banues në Gjilan", bëri me dije Vocaj. Ai tha se gjatë këtij operacioni u sekuestruan 203 kallëpe me lëndë plasëse të dyshuara të jenë tritol me peshë 46 kilogramë. Vocaj tha se kjo sasi eksplozivi dyshohej se do të përdorej nga grupe kriminale të ndryshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pamjet që publikoi Policia e Shtetit tregonin se kallëpet e lëndës eksplozive ishin fshehur në kutitë e lëngjeve të frutave. Gjithashtu, policia sekuestroi edhe tre celularë dhe një automjet. Më herët, po ashtu, janë zhvilluar dy operacione dhe janë arrestuar dy persona e janë sekuestruar katër armë zjarri pistoleta, së bashku me këhra dhe municione luftarake, të cilat janë trafikuar nga Kosova në drejtim të Shqipërisë.

UP-ja ua hap dyert studentëve ndërkombëtarë për punë praktike

PRISHTINË, 5 SHKURT - Universiteti i Prishtinës ka hapur dyert për studentë ndërkombëtarë për punë praktike, përmes bashkëpunimit të ri me Isla Internships Abroad. Universiteti i Prishtinës sot ka lidhur partneritet me Isla Internships Abroad. Ky bashkëpunim iu ofron mundësi praktikantëve të talentuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të

kryejnë praktikë profesionale në Universitetin e Prishtinës. Rektori i UP-së, Qerim Qerimi, ka theksuar rëndësinë e përvojave ndërkombëtare për zhvillimin e aftësive dhe perspektivës së studentëve. Sipas tij, ky partneritet hap dyert për një nivel të ri të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përmirësuar cilësinë e arsimit dhe duke sjellë një vlerë të shtuar në zhvillimin e

karrierave të studentëve tanë. Isla Internships Abroad, gjithashtu, është e përkushtuar në vlerat e diversitetit dhe drejtësisë sociale. Organizata promovon përfshirjen dhe njeh vlerat e ndryshme nga sfondet, kulturat dhe identitetet e ndryshme. Kjo do t'u ofrojë studentëve të UP-së një përvojë të pasur dhe të përgatitur për të ardhmen e tyre.





Ministri gjerman i Mbrojtjes në Prishtinë: Bëjmë thirrje për maturi dhe kujdes

Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, po qëndron në Kosovë për vizitë zyrtare. Pas një takimi që ka pasur të hënën me presidenten Vjosa Osmani, ai ka premtuar mbështetje për Kosovën në rrugën evropiane, ndërkaq ka theksuar se nevojitet përparim i dukshëm në marrëdhëniet Kosovë - Serbi. Pistorius gjatë konferencës së përbashkët për medie me Osmanin, ka theksuar se Gjermania, pas ShBA-së, është një nga mbështetëset më të mëdha të Kosovës si nga aspekti civil, po ashtu edhe ushtarak. “Ne, marrë parasysh tensionet aktuale me Serbinë, dhe pakicën serbe në Kosovë, bëjmë thirrje të qartë për maturi dhe kujdes”, ka theksuar Pistorius

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 5 shkurt - Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, ka kërkuar shtensionim të situatës në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke bërë thirrje për rikthim në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Pistorius, i cili po qëndron në Kosovë për vizitë zyrtare, foli në një konferencë për medie në Prishtinë, bashkë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. “Ne, marrë parasysh tensionet aktuale me Serbinë,

dhe pakicën serbe në Kosovë, bëjmë thirrje të qartë për maturi dhe kujdes”, ka theksuar Pistorius.

Ai shtoi se Kosova duhet të kontribuojë në shtensionim e situatës, mirëpo edhe roli i Serbisë është një rol i veçantë. Pistorius ka theksuar se thirrje për dialog dhe shtensionim do të bëjë edhe në kuadër të udhëtimit të tij në Serbi. “Sa iu përket marrëdhënieve në mes të Serbisë dhe Kosovës, kërkesa e ditës është shtensionimi. Kancelari [gjerman, Olaf Scholz] e ka nënvizuar që e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në

Evropë, por kjo parasheh si kusht dialogun dhe askush nuk duhet dhe nuk mund të ketë një interes në tensionin e mëtejshëm të situatës”, ka thënë ai.

Gjatë konferencës për medie, Osmani ka thënë se politika shtetërore e Serbisë “vazhdimisht po e sfidon integritetin territorial të Kosovës dhe angazhohet për akte agresioni ndaj Kosovës”. Ajo shtoi se “për t’i parandaluar këto sulme në të ardhmen ne kemi nevojë për përkrahjen e Gjermanisë, sikurse edhe të aleatëve e partnerëve të tjerë euroatlantikë”.

Osmani ka thënë se është koha

që Kosova t’i bashkohet NATO-s, duke filluar me Partneritetin për Paqe. “Një hap i tillë do të ndikonte pozitivisht në sigurinë, paqen dhe stabilitetin e të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor”, është shprehur presidentja Osmani.

Në Prishtinë, Boris Pistorius premtoi mbështetje për Kosovën në rrugën evropiane, ndërkaq theksoi se nevojitet përparim i dukshëm në marrëdhëniet Kosovë - Serbi. “Kjo është e rëndësishme për rajonin, Kosovën dhe të gjithë Evropën”. Pistorius ka pohuar se Gjermania, pas ShBA-së, është një nga mbështetëset më të mëdha të Kosovës si nga aspekti civil, po ashtu edhe ushtarak. “Dhe, kjo do të jetë kështu edhe në të ardhmen, këtë jua siguroj”, ka thënë ai.

Ndërkaq, Osmani përmendi sulmin e 24 shtatorit në Banjskë, pjesa veriore e Kosovës, kur në shtator të vitit të kaluar një grup i armatosur serb e ka sulmuar Policinë e Kosovës, duke e vrarë

rreshterin Afrim Bunjaku.

Ajo ka thënë se prej atëherë Serbia nuk e ka ndërprerë mbështetjen për grupet terroriste dhe paramilitare. “Të gjitha dëshmitë që i marrim nga institucionet tona të sigurisë tregojnë që Serbia vazhdon të planifikojë sulme të reja. Ajo çfarë dua t’i sigurojë qytetarët e Kosovës është që Serbia nuk do t’ia dalë”, ka thënë presidentja Osmani.

Duke folur për bashkëpunimin me Gjermaninë, Osmani ka theksuar se ky shtet qëndroi pranë nesh në kohë të vështira e vazhdon të qëndrojë si partnere e palëkundur e Republikës sonë. “Falënderova ministrin Pistorius për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm bilateral ushtarak si dhe për mbështetjen gjermane në kuadër të forcave të KFOR-it. Kosova është më e fortë bashkë me aleatët e saj”, ka deklaruar presidentja Osmani.

Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, ka folur edhe për rregulloren e re të BQK-së, e cila

Hovenieri insiston në shtyrjen e zbatimit të rregullores së BQK-së

PRISHTINË, 5 SHKURT - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, e ka përsëritur të hënën kërkesën ndaj Qeverisë së Kosovës për shtyrje të vendimit për zbatim të rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Ai i ka bërë këto deklarata pas një takimi që ka zhvilluar të hënën me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe diplomatë të tjerë të huaj.

Rregullorja e BQK-së, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt, parasheh që valuta e vetme për kryeje të pagesave në Kosovë të jetë euroja. Kështu, serbëve të Kosovës u pamundësohet përdorimi i dinarit. "Ne natyrisht se përkrahim përpjekjet për t'i shmangur krimet financiare, shpëlarjen e parave, financimin e terrorizmit dhe të ngjashme, por ne kemi shqetësime të thella për mënyrën e zbatimit të kësaj rregulloreje, pasi besojmë se nuk i merr parasysh disa shqetësime të komuniteteve", ka pohuar ai.

I pyetur nëse qeveria amerikane mund të marrë veprime kundër Kosovës, nëse nuk i përgjigjet kësaj kërkesë, Hovenieri ka thënë se "shpresojmë që qeveria të jetë partnere me ne", duke shtuar që nëse ndodh e kundërta, kjo gjë "do të ketë ndikim në kualitetin e partneritetit tonë". Hovenieri ka thënë se ndonëse Shtetet e Bashkuara e mirëpresin vendimin e Kosovës për respektim të Kushtetutës së vendit, ShBA-ja beson që duhet të ketë periudhë edukuese për rregulloren e re. Kur është pyetur për reagimin e qeverisë ndaj kërkesës së tij dhe faktorit ndërkombëtar,



Hovenieri ka thënë se "do t'i lë ata të flasin" në këtë drejtim. ShBA-ja, Bashkimi Evropian dhe mekanizma të tjerë e kanë kritikuar që disa ditë Qeverinë e Kosovës për mosshyrje të zbatimit të rregullores. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, është zotuar se do të sigurohet tranzicion i lehtësuar. Hovenieri ka thënë se shpreson që në këtë periudhë tranzitore të merren parasysh shqetësimet e faktorit ndërkombëtar.

Bashkimi Evropian ka sqaruar edhe gjatë ditës së hënës se reagimet gjatë fundjavës ndaj disa zhvillimeve në Kosovë kanë pasur për qëllim t'i shmangin tensionet pas disa veprimeve të autoriteteve të

Kosovës që BE-ja i ka quajtur "të njëanshme dhe shqetësuese".

Këtë e ka thënë të hënën në një konferencë me gazetarë, Peter Stano, zëdhënës i BE-së për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë. "Përgjatë javës së shkuar kemi parë se paku dy shembuj të veprimeve që kanë nxitur shqetësimin e Bashkimit Evropian. Njëri ishte rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës, tjetri operacionet policore ndaj disa entiteteve të udhëhequra nga Serbia. Këta hapa janë shqetësues për shkak se ata nuk kontribuojnë në shtensionimin e situatës", ka thënë Stano.

Po ashtu, më 2 shkurt, në një aksion policor, autoritetet e Kosovës mbyllën tri komuna në Pejë, Istog dhe Klinë, të cilat

funksiononin paralelisht në sistemin serb.

Stano ka theksuar se "ato veprime, zakonisht, nuk janë të koordinuara, janë të njëanshme dhe pa nivelin e duhur të konsultimeve paraprake për ta shmangur ndikimin negativ që mund të kenë ndaj njerëzve në terren. Prandaj, Bashkimi Evropian reagoi ndaj të dyja këtyre zhvillimeve".

Sipas zëdhënësit të BE-së, këto deklarata ishin përforcuar edhe nga partnerët e tjerë ndërkombëtarë si dhe nga ana e Komisionit Evropian. "Natyrisht se është shqetësuese kur shohim se një varg i hapave të njëanshëm mund të çojë deri te diçka që ne nuk do të donim të shihnim - përkeqësimi i situatës në terren. Sepse, një gjë është e

qartë, ato veprime nuk japin kontribut për ta qetësuar situatën dhe për t'i ndihmuar që njerëzit të ndihen se jeta e tyre po bëhet më e mirë. Krejt e kundërta. Prandaj është e rëndësishme të kthehen në dialog", ka thënë ai.

Duke iu përgjigjur pyetjeve se a planifikohen takime të shpejta në kuadër të dialogut, zëdhënësi i BE-së ka thënë se po punohet në atë drejtim, porse nuk ka ndonjë datë të paraparë. "Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së, Miroslav Lajčak, po punon me partnerët nga të dyja palët në rajon dhe në BE, si dhe me bashkësinë më të gjerë ndërkombëtare, në mënyrë që të mundësohet që të dyja palët të fillojnë të sillen në mënyrë konstruktive, të kthehen në tryezën e bisedimeve dhe t'i diskutojnë çështjet e rëndësishme pa hapa të njëanshëm", është shprehur Stano, duke shtuar se nuk janë në gjendje të shpallin ndonjë datë të ndonjë takimi të radhës. "Përfaqësuesi i posaçëm po punon me një ritëm të përditshëm dhe shpresojmë se në një moment do të do të jemi në gjendje të caktojmë një takim të nivelit të lartë të presidentit nga Serbia dhe kryeministrin nga Kosova, ku do të bënim përpjekje për t'u ndihmuar t'i zgjidhin çështjet", ka thënë ai, por ka përsëritur se "tash për tash nuk ka ndonjë afat kohor të caktuar". "Ne u bëjmë thirrje autoriteteve të Kosovës të angazhohen në procesin e konsultimeve dhe t'i shmangin hapat e tjerë të njëanshëm sepse ata hapa kanë vërtet një efekt kundërproduktiv", ka thënë Stano.

Zllatan Arsiq lirohet nga akuza për krime lufte në Kosovë

Prishtinë, 5 shkurt - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka liruar Zllatan Arsiqin nga akuza për krime lufte, që përfshinte periudhën gjatë vitit 1999 në Kamenicë.

Me aktgjykimin e shpallur të hënën, më 5 shkurt, atij i është ndërprerë edhe paraburgimi.

Arsiq akuzohej se bashkë me pjesëtarë të policisë serbe dhe të grupeve paramilitare kanë marrë pjesë në dëbimin dhe shpërnguljen me dhunë të banorëve të Kamenicës me

rrethinë.

Ai akuzohej edhe për dëmtim me qëllim të pronave të shqiptarëve.

Sipas aktakuzës, ai kishte ndaluar, me veturë të policisë serbe, personin me iniciale B. M. dhe familjarët e tij dhe më pas i kishte keqtrajtuar.

Në aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Kosovës thuhet se kjo kishte ndodhur në mars të vitit 1999, pas bombardimeve të NATO-s. "Ku po i dërgon këto cigare? UÇK-së po ia dërgon?", citohet t'i ketë thënë

Arsiq në Stacionin Policor në Kamenicë, personit B. M., sipas aktakuzës.

Personi B. M. ishte rrahur nga Arsiq, në bashkëkryerje me persona të tjerë, thuhet në aktakuzë.

Gjithashtu, në aktakuzë thuhet se pas kësaj B. M. ishte kthyer në shtëpinë e djegur, nga ishte dëbuar. "Në oborr i akuzuari e kishte goditur e kërcënuar me vrasje e më pas policia serbe e kishte liruar atë dhe familjen e tij", thuhet në aktakuzë.



ka hyrë në fuqi më 1 shkurt, ku parashihet që valuta e vetme për kryerje të pagesave në Kosovë të jetë euroja.

Pistorius ka thënë se Kosova ka të drejtë ta zbatojë ligjshmërinë, duke e vendosur euron si valutë të vetme por, sipas tij, duhet të

jepet kohë për zbatimin e rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). "Besoj është më mirë të realizohet rregullorja, por të jepet një afat më i gjatë për zbatimin e saj", tha ministri gjerman.

Sipas tij, vendosja e euros si

valutë e vetme duhet të komunikohet në mënyrë të përshtatshme, "ashtu që askush të mos ketë frikë dhe të mos jetë i painformuar".

Në anën tjetër, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se "aleatët tanë asnjëherë nuk kanë

qenë pro dinarit serb, dhe nuk kanë qenë kundër sundimit të ligjit".

Ajo ka thënë se rregullorja e BQK-së nuk është kundër dinarit. "Nuk shoh asgjë jonormale në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të Republikës së

Kosovës dhe aleatëve tanë ndërkombëtarë në gjetjen e rrugëve shumë efektive nëpërmjet të cilave do të informoheshin qytetarët e Republikës së Kosovës se si do të zbatohet rregullorja e BQK-së", ka thënë Osmani.

ROLI I ISH-TË BURGOSURAVE POLITIKE NË LËVIZJEN E PAJTIMIT TË GJAQEVE 1990-1991 NË KOSOVË (2)

Myrvete Dreshaj dhe Have Shala, vajzat e para që u ulën krahas burrave në odën shqiptare për pajtimin e gjaqeve

Hyrja e Myrvete Dreshajt dhe Have Shalës në odën e burrave, ku po mbahej e pamja për dëshmorin Gani Dacin, shënon hyrjen e parë të vajzës/gruas shqiptare në odën shqiptare, në këtë rast në funksion të pajtimit të gjaqeve, e dedikuar, sipas traditës dhe mentalitetit patriarkal, kryesisht për burra



Lulëzim ETEMAJ

Aksioni i filluar nga grupi i të rinjve të Pejës kërkonte punë, përkushtim, fitimin e mbështetjes, në radhë të parë nga familjet e dëmtuara, por edhe mbështetjen e qytetarëve të tjerë, të të gjitha moshave, djem, vajza, burra dhe gra. Në të kundërtën nuk mund të arrihej qëllimi që ata i kishin vënë vetes - pajtimin ndërshqiptar dhe shuarjen e gjakmarrjes përmes faljes së gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave. Në funksion të këtij misioni nismëtarët

e realizojnë edhe takimin e parë me qytetarë në të pamën (11) e organizuar për dëshmorin Gani Daci (22 vjeç) për shpjegimin e qëllimit të nismës së tyre. Ai, ashtu si dhe Qamil Morina (19 vjeç) e Ali Hysvukaj (19 vjeç), ishte vrarë nga forcat serbe në demonstratën e organizuar në Pejë më 31 janar 1990 (12). Hyrja e Myrvete Dreshajt dhe Have Shalës në odën e burrave, ku po mbahej e pamja, shënon hyrjen e parë të vajzës/gruas shqiptare në odën shqiptare, në këtë rast në funksion të pajtimit të

gjaqeve, e dedikuar, sipas traditës dhe mentalitetit patriarkal, kryesisht për burra. Dëgjimi me vëmendje i fjalës së tyre mbi rëndësinë e pajtimit të gjaqeve si dhe situatën e rëndë politike në të cilën po kalonte Kosova, i pasuar nga reagimi pozitiv edhe nga burrat pleq plisbardhë, ishte një shenjë e mirë, shumë premtuese, njëherësh edhe inkurajuese për nismëtarët.

Dy muaj besë të arritura nga ndërhyrja e parë më 2 shkurt 1990 në Lumbardh të Deçanit; një pajtim, më 10 shkurt, te Buqollët në

Raushiq të Pejës; si dhe dy falje gjaqesh, këto ishin rezultatet e para të shënuara nga grupi i të rinjve të Pejës. Ishin shënuar, po ashtu, dhjetëra kontakte dhe biseda me familjet e dëmtuara dhe pritej shtrirja e dorës së pajtimit mes tyre.

Në përputhje me vendimin e marrë për ta filluar pajtimin e gjaqeve, që pajtimi i gjaqeve të shtrihej në të gjithë Kosovën (13), me ndihmën e Have Shalës formohet Këshilli i Pajtimit të Gjaqeve në Rahovec. Po ky këshill më 17 mars 1990 organizon tubimin e parë

publik të faljes së gjaqeve në Kosovë. Në të u falën pesë gjaqe dhe katër plagë. Krahas ndihmës dhënë për përgatitjen e tij nga Have Shala dhe Myrvete Dreshaj, kjo e fundit u drejtohet të pranishmëve me një fjalë rasti, përmes së cilës kërkon mbështetjen e aksionit të rinisë për pajtimin e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave. Krahas hyrjes së parë në odë të tyre, paraqitja publike e Myrvete Dreshajt shënon, përmes marrjes së parë të fjalës në publik për ta kërkuar pajtimin e gjaqeve, avancimin e rolit të vajzës

shqiptare, si ish-e burgosur politike, në pajtimin e gjaqeve.

Në ndërkohë, grupit të të rinjve të Pejës, pas arritjes së pajtimit të parë, më 10 shkurt 1990, i bashkëngjiten edhe dy ish-të burgosura të tjera politike, Akile Dedinca (1963), nga fshati Vragoli i Fushë-Kosovës, dhe Zoge Shala (1966) nga fshati Rashiq, komuna e Pejës. Kështu, numri i vajzave, ish-të burgosura politike, në raport me numrin e djemve, në këtë grup tani ishte katër me tre, në favor të vajzave. Kuptohet, bëhet fjalë për një periudhë të caktuar, pasi që Akile Dedinca kthehet pas një kohe për ta përhapur pajtimin e gjaqeve edhe në vendbanimin e saj. Porse, si bërthamë, grupi i të rinjve të Pejës do të ketë raport konstant, tri ish-të burgosura politike: Have Shala, Myrvete Dreshaj dhe Zoge Shala, dhe tre ish-të burgosur, po ashtu politikë: Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj.

Nuk është vetëm Këshilli i Pajtitimit në Rahovec që është themeluar me mbështetjen e nismëtareve të pajtitimit të gjaqeve. Myrvete Dreshaj e ndihmon edhe themelimin e Këshillit të Pajtitimit dhe fillimin e pajtitimit të gjaqeve edhe në Tetovë e Gostivar, ku qëndron së bashku me Lulëzim Etemajn për një kohë të caktuar më të përfunduar të tubimit për pajtimin e gjaqeve të mbajtur më 1 maj 1990 te Verrat e Llukës. Përkrahje të kohëpaskohshme Tetovës dhe Gostivarit i ofrojnë edhe Zoge Shala dhe Shyhrete Malaj.

Në Tetovë dhe Gostivar, bartësve të nismës së pajtitimit të gjaqeve: Adnan Abdullahi - Voka, Afrim Ibrahim - Fanda, Dashmire Rizvani, Resmije Abdurrahmani, Hirijete Tahiri, Besime Muharremi, krahas Mehmetrizza Murtezanit - Gega, Valdete Fejzullahit, Tahir Abdullahit, Afërdita Cekës, Mensur Fejzullahit, Izet Fejzullahit, Nuredin Alijit, Xhevat e Nexhat Ahmetit, Fatime Fejzullahit, Isak Sherifit, profesorëve

Ramadan Sinani dhe Fadil Sylejmani, Vebi dhe Remzi Beqirit, Luan Veliut, Naser Veliut, Skender Isenit, Xhevat Ademit, iu bashkëngjiten që herët ish-të burgosurat politike Nafije Zendeli (1971) dhe Valdete Fejzullahi (1972-2004).

Në funksion të shtrirjes së pajtitimit përmes themelimit të këshillave të rinj, apo dhe zhvillimit të veprimtarisë pajtimtare, Myrvete Dreshaj dhe Have Shala i ofrojnë mbështetje edhe Drenasit, Gjakovës, Rozhajës, Besianës, Rugovës, ku në Këshillin e Pajtitimit vepronte ish-e burgosura politike Zyrafete Muriqi (1966), Koshutan (Pejë), po ashtu e dënuar si anëtare e Grupit "IDEALI", si dhe Istogut, ku ishte aktive ish-e burgosura politike nga kjo komunë, Lumnije Dreshaj (1967), me vendbanim në fshatin Vrellë.

Shyhrete Malaj (1963), Hogosht (Kamenicë), Hidajete Krasniqi (1960), Leshan (Pejë), Fikrije Musa (1968), Velikarekë (Besjanë) janë tri ish-të burgosura të tjera politike, të cilat, pas rënies në kontakt me Myrvete Dreshajn, Have Shalën, Zoge Shalën, Akile Dedincën apo ndonjërin nga tre nismëtarët e tjerë të pajtitimit të gjaqeve, janë angazhuar në veprimtarinë pajtimtare dhe kanë vepruar në anë të ndryshme të Kosovës, si në Këshillin e Pajtitimit në Hogosht (14) (Shyhrete Malaj), në kuadër të Këshillit të Pajtitimit të Pejës (Hidajete Krasniqi), apo në rrethe të ndryshme, siç ishte rasti i Fikrije Musës (15). Lumnije Azemi (1963), ndërkaq, është studentja tjetër, ish-e burgosur politike që angazhohet po në pajtimin e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave, duke u bërë veprimtare e Këshillit të Pajtitimit në Ferizaj (16).

Pjesëmarrja e vajzës shqiptare në drejtimin e pajtitimit të gjaqeve, një nga segmentet më përdalluese të Lëvizjes së Pajtitimit të Gjaqeve

Angazhimi i madh, si i

nismëtarëve ashtu edhe i veprimtarëve të tjerë të shumtë, dhe mbështetja që gjeti iniciativa për pajtimin e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave, janë dy faktorët kryesorë të cilët bënë që për një kohë të shkurtër, afërsisht mbi një muaj, të themeloheshin këshillat e pajtitimit në pjesën më të madhe të Kosovës. Si rrjedhojë, ishte shtuar edhe numri i gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave të falura. Pajtimi, që pas tubimit të parë publik në Rahovec, i mbajtur më 17 mars 1990, i pasuar me tubime të tilla të mbajtura në të njëjtën ditë në Sankoc, Korroticë të Epërme, Vukoc të Drenicës dhe në Mitrovicë, tashmë kishte dalë jashtë odës shqiptare, aty ku kishte filluar. Ashtu sikurse në oda, vajzat shqiptare, ish-të burgosura politike, edhe në këto tubime luajtën rol të pazëvendësueshëm qoftë në organizimin, qoftë në drejtimin e tyre.

Paraqitja e Zoge Shalës në tubimin e mbajtur në Shtupeq të Madh të Rugovës, më 25 mars 1990, si kumtuese e emrave të personave që falën gjaqet dhe shtrinë dorën e pajtitimit, Myrvete Dreshajt dhe Have Shalës me një fjalë rasti para të pranishmëve, me theks të veçantë për rëndësinë, si në aspektin human ashtu dhe në atë kombëtar të pajtitimit të gjaqeve, pasohet me paraqitje edhe në tubime të tjera. Një ndër ta, nga më të mëdhenjtë, është tubimi i mbajtur më 1 maj 1990 te Verrat e Llukës, komuna e Deçanit. Në këtë tubim, pavarësisht prej pengesave të shumta dhe dhunës së policisë serbe, ia arritën të mblidhen mbi 500 mijë shqiptarë nga e gjithë hapësira e Shqipërisë së këndeje Drinit. Tubimi u drejtua nga Have Shala së bashku me Jashar Salihun, po ashtu ish-i burgosur politik. Në të u arritën gjithsej 106 pajtime: 62 gjaqe, 25 plagë dhe 19 ngatërresa.

Në tubimin tjetër masiv, të mbajtur të nesërmen, më 2 maj 1990, në Gjonaj të Hasit, Have Shala u drejtohet mbi 100 mijë të pranishmëve, duke kërkuar mbështetje dhe gatishmëri

prej tyre për t'i falë të gjitha gjaqet, plagët dhe ngatërresat që t'i jepet fund gjakmarrjes. Njëjtë vepron edhe Myrvete Dreshaj në tubimin e organizuar më 28 korrik 1990 në "Rudinën e Pajtitimit", bri Malit të Thatë, në Çegran të Gostivarit, ku, pavarësisht prej pengesave dhe ndjekjeve nga policia maqedonase, ishin tubuar mbi 50 mijë pjesëmarrës. Në këtë tubim u bë promovimi i shtrirjes së dorës së pajtitimit nga nëntë familje: u falën tri gjaqe dhe gjashtë ngatërresa. Nismëtarja e pajtitimit të gjaqeve, Myrvete Dreshaj, kishte ndihmuar së bashku me Lulëzim Etemajn edhe përgatitjen e tubimit. Në mesin e organizatorëve të shumtë, burra dhe gra, djem dhe vajza, që punuan me përkushtim, janë edhe ish-të burgosurat politike Nafije Zendeli dhe Valdete Fejzullahi.

Bazuar në numrin e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave të falura, këshillave të pajtitimit të formuara, tubimeve publike si dhe vullnetarëve të angazhuar, aksioni për pajtimin e gjaqeve i kishte tejkaluar për kohë të shkurtër kornizat e tij. Tashmë ai ishte shndërruar në çdo aspekt në lëvizje gjithëpopullore. Në funksion të analizës së punës së deriatëhershme dhe planveprimtarisë për të ardhmen, më 19 maj 1990 në Strelc të Epërm të komunës së Deçanit mbahet Kuvendi I i Lëvizjes së Pajtitimit të Gjaqeve. Sipas të dhënave të paraqitura nga përfaqësuesit e 21 këshillave të pajtitimit, brenda kësaj periudhe më shumë se tremujore ishin shënuar 1 266 pajtime: 653 gjaqe, 223 plagë dhe 388 ngatërresa. Punimet e Kuvendit i drejtoi Anton Çetta. Me miratimin e pjesës më të madhe të pjesëmarrësve u vendos që Grupi i të Rinjve të Pejës ta formojë Këshillin Koordinues të Lëvizjes së Pajtitimit të Gjaqeve në Kosovë (17), me qendër në Pejë. Grupin e të Rinjve të Pejës e përbënin pesë nismëtarët: Have Shala, Myrvete Dreshaj, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj.

Përmes këtij vendimi, Lëvizja e Pajtitimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë bashkëdrejtohej, edhe zyrtarisht de jure, nga dy vajza dhe tre djem, të gjithë ish-të burgosur politikë.

Pjesëmarrja e vajzës shqiptare në drejtimin e pajtitimit të gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave paraqet një nga segmentet më përdalluese të Lëvizjes së Pajtitimit të Gjaqeve karshi të gjitha formave të mëparshme të pajtitimit të gjaqeve që i ndeshim në historinë e popullit shqiptar.

Në përputhje me përgjegjësinë që ua kishte ngarkuar Kuvendi I nismëtarëve të pajtitimit të gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave, Have Shala drejton punimet e Kuvendit II, i cili mbahet më 18 nëntor 1990 në Osek Hylë të Gjakovës. Mbajtja e kuvendit ishte caktuar dhe organizuar me vendim të Këshillit Koordinues. Krahas Have Shalës, në të marrin pjesë edhe Myrvete Dreshaj, Zoge Shala dhe Lulëzim Etemaj.

Nga raportet e paraqitura nga përfaqësuesit e 18 këshillave në Kuvend, rezultoi se, që nga data 2 shkurt 1990 ishin arritur të faleshin 702 gjaqe, 250 plagë dhe 508 ngatërresa, ndërsa kishin mbetur pa u pajtuar edhe 169 gjaqe, 35 plagë dhe 69 ngatërresa.

Kuvendi II, pas një sërë debatesh, ndër të tjera, miratoi edhe programin për veprimin e mëtejshëm, deri në njëvjetorin e nismës, më 2 shkurt 1991, si dhe e konfirmoi si të drejtë qëndrimin e mbajtur deri atëherë nga anëtarët e Këshillit Koordinues, si dhe nga pjesa më e madhe e këshillave të pajtitimit, për të mos ndërhyrë dhe kërkuar falje për gjaqet, plagët dhe ngatërresat e shkaktuara pas datës 2 shkurt 1990, si dhe për të mos kërkuar faljen e gjakut në rastet kur vrasja ishte e karakterit politik.

(Punimi është botuar në revistën e Shkencave Albanologjike, "Studime albanologjike", nr. 23, Shkup 2023. Fusnotat publikohen në fund të punimit. Vijn.)

REAGIM I KMDLNJ-së PËR FATURAT E RRYMËS

A ka humbur besimi në institucione apo qytetarët janë jashtë mundësive t'i realizojnë të drejtat e tyre?

Në fund të vitit 2023 ndaj qytetarëve të Kosovës vazhdoi shkelja e të drejtave të tyre përmes fryrjes enorme të faturave të energjisë elektrike, e që për fatin e keq pati një jehonë mediatike për një kohë shumë të shkurtë. KMDLNj, që nga pranimi i ankesave të para për fryrje përkatësisht plaçkitje të qytetarëve përmes fryrjes së faturave të energjisë, e që për fatin e keq nuk është as hera e parë dhe e as e vetmja që qytetarët detyrohen të paguajnë për energjinë të cilën nuk e kanë shpenzuar ka reaguar fuqishëm kundër këtyre shkeljeve dhe shkelësve duke i bërë thirrje dhe prokurorisë të nisë hetimet. Për më keq, po këta qytetarë, përveç ankesave duke i shfrytëzuar edhe të gjitha rrjetet sociale përmes publikimit të faturave të energjisë asnjëherë nuk janë marrë seriozisht dhe ankesat e tyre nuk janë trajtuar fare. ZRrE, si autoritet rregullativ dhe ekzekutiv asnjëherë nuk ka qenë, dhe vazhdon të mos jetë në krah të qytetarëve për t'i përkrahur ata në të drejtën e tyre dhe t'i mbrojnë nga keqbërësit e KES/CO / KEDS. Ende pa u kompensuar për vjedhjet e

mëparshme për të cilën e ka vërtetuar dhe Gjykata Kushtetuese vjedhjet e KESCO vazhduan. Përdërisa nuk ka një autoritet i cili mbikëqyr dhe dënon, në rast kur ka bazë për këtë, KESCO do të vazhdojë të godasë qytetarët e Kosovës me fryrje të vazhdueshme të faturave të energjisë elektrike. Për këto shkelje nuk reagojnë në masën e duhur as përfaqësuesit e popullit, të cilët janë treguar gjithashtu injorues ndaj votuesve të tyre dhe qytetarëve në përgjithësi. Kurse, Qeveria e Kosovës për të larguar vëmendjen nga një problem real, plaçkitja e fatyrave të energjisë për qytetarët na servuan tema ende më të rëndësishme siç është siguria e vendit. Qytetarët të gjendur në një situatë kur askund dhe askush nuk u doli në mbrojtje të të drejtave të tyre u gjenden dhe vazhdojnë të shpresojnë se ndoshta një ditë do të bëhet mirë. Një numër i qytetarëve të cilët janë ankuar në KMDLNj kanë pohuar se do të jetë fatura e fundit të cilën po e paguajnë në Kosovë, duke pohuar se ata po largohen nga Kosova për



faktin se vendi i tyre nuk po i mbron ata dhe të drejtat që u takojnë atyre. KMDLNj disa herë ka reaguar në kuptimin e sensibilizimit të çështjes dhe kthjellimin e institucioneve të cilat janë të thirrura me ligj që të mbrojnë qytetarët e Kosovës për shkeljet që u bëhen por si duket nuk kanë qenë në prioritet e tyre qytetari i vendit. Për të gjitha shkeljet përmes fryrjes së faturave të energjisë elektrike KMDLNj u ka

bërë thirrje qytetarëve që përmes padive individuale të padisin ZRrE dhe KESCO për plaçkitje dhe shkelje të të drejtave të tyre. Për të gjithë qytetarët është koha kur duhet të veprojnë dhe të ngrejë zërin për të drejtat e tyre dhe të dalin në mbrojtje të të drejtave, sepse institucionet e kanë dëshmuar se janë të "zëna" me punë/probleme më madhore. Andaj, të mos çuditemi kur edhe në ditët, muajt e vitet në vazhdim rrugët po do të jenë të lira, nuk do

të ketë kolona, nuk do të ketë numër të mjaftueshëm të nxënësve nëpër klasë e shkolla, nuk do të ketë mësues e mjekë, nuk do të ketë punëtorë të mjaftueshëm, nuk do të ketë rini, etj. sepse, për fatin e keq jetën të cilën donin ta bënin në Kosovë, në vendin e tyre nuk e patën mundësinë.

Qeveria e Kosovës doli me një informatë se më nuk do të paguaj rrymën për serbët e veriu për faktin se "Elektrosever", kompania nga Serbia ka filluar të shpërndajë faturat qytetarëve që për 25 vite nuk i kanë paguar faturat e rrymës dhe të cilat i kanë paguar qytetarët shqiptarë dhe joserbë që ishte vërtetuar edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. KMDLNj ka dyshime të bazuara se faturat e shpërndara nga "Elektroseveri" i Serbisë po paguhen andaj kërkon nga qeveria e Kosovës të dalë me shifra se sa përqind është paguar rryma sa faturimit. KMDLNj dyshon se plaçkitjet që po bëhen nga KES/CO, KEDS dhe ZRrE, me miratimin e plotë të qeverisë, edhe më tutje po përdoren për faturat e serbëve të veriu.

Ministria e Bujqësisë kthen në pronësi pronën në vlerë prej 4 milionë eurosh, në vitin 2021 i ishte dhënë një serbi

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 SHKURT - Ministri i Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, në një konferencë për medie mbajtur të hënën, ka njoftuar se kanë arritur ta kthejnë një pronë në vlerë prej 4 milionë eurosh, e cila i ishte dhënë një serbi.

Peci ka deklaruar se një sipërfaqe prej një sipërfaqe prej 1 hektar e 34 ari, me vlerë të përafërt prej 4 milionë eurosh, pronë e Ministrisë së Bujqësisë, në vitin 2020 është bartur te pronari Jovica Deniq. "Pas pronave në Ulpianë dhe në Stankaj të Pejës, ky rast, për të cilin po flasim sot, është një ndër rastet më bizare që kanë ndodhur karshi tentimit për tjetërsim dhe abuzim flagrant të pronave shtetërore. Mënyra e tjetërsimit të kësaj prone për mua si ministër, por po besoj edhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që e duan këtë vend, paraqet krim", ka deklaruar ai. Ministri Peci ka theksuar se nga të dhënat që kanë, që nga viti 2010 deri në vitin 2020 janë rreth 100 hektarë toke të tjetërsuara, objekte e prona afariste, që kanë ndërruar titullarin në mënyrë të dyshimtë përmes metodës së identifikimit të disa pjesëtarëve të komunitetit



serb, ish-zyrtarë të Institutit të Bujqësisë së Kosovës. "Si vazhdimësi e sensibilizimit vazhdojmë ta njoftojmë opinionit publik dhe organet e rendit e drejtësisë për shkeljet flagrante ligjore të cilat kanë autorë e për të

cilët institucionet e drejtësisë duhet ta japin vendimin dhe epilogun meritor. Në aktvendimin e nxjerrë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në dhjetor të vitit 2020, ishte obliguar Drejtoria e Kadastrës e komunës


së Prishtinës që ta bëjë ekzekutimin e Aktgjykimit të shtatorit të 1996-s, ku parcela në të cilën ndodhemi sot, i është bartur në pronësi Jovica Deniqit", ka thënë Peci.

Ai ka vazhduar se Drejtoria e Kadastrës e komunës së Prishtinës në maj të 2019-s si dhe në gusht të 2020-s kishte refuzuar fillimisht kërkesën e Jovica Deniqit, për shkak të konstatimit të zbrazëtisë ligjore për ta bartur pronën në pronësi të Deniqit. "Mirëpo, në janar të vitit 2021, e njëjta drejtori nxjerrë aktvendimin me të cilin është ekzekutuar në regjistra kadastrale aktvendimi i datës 11.12.2020, kurse me datë 21.06.2021 Drejtoria e Kadastrës e komunës së Prishtinës, bazuar në shkresën e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës të datës 17.05.2021, ka nxjerrë aktvendimin me të cilin është plotësuar aktvendimi i nxjerrë nga Drejtoria e Kadastrës me datë 19.01.2021, me të cilin Jovica Deniq është bërë pronar i kësaj ngastre kadastrale në të cilën ndodhemi. Na është dashur shumë angazhim dhe sensibilizim publik e kërkesa ndaj institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve të lartcekura; Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Drejtorisë për Kadastër të

Komunës së Prishtinës (e cila ka refuzuar në vazhdimësi dhënien e historiatit të mënyrës së bartjes së pronës nga MBPZhr të Jovica). Si rezultat i këmbëngulësisë sonë, aktorët e lartcekur që kanë marrë vendime skandaloze dhe kriminale me vite në përvetësimin e pronës shtetërore tek individë e konkretisht të kësaj ngastre në vlerë rreth 4 milionë euro; prona i është kthyer titullarit / Ministrisë së Bujqësisë, para 6 ditësh. Mirëpo kjo nuk mjafton! Unë ftoj Prokurorinë e Shtetit të angazhohet dhe t'i hetojë të gjithë mënyrat dhe procedurat e bartjes së pronës së Ministrisë së Bujqësisë te grupe apo individë, e që janë hiq me pak se qindra hektar me tokë, objekte afariste e objekte banimi", ka deklaruar ministri Peci.

Ai ka shtuar se secili duhet ta bartë peshën e përgjegjësisë karshi këtyre veprimeve skandaloze e kriminale, që atyre që kanë vepruar në këtë formë po edhe ata që e kanë lejuar dhe nuk kanë ndërmarë asnjë veprim të vetëm. Secili duhet të përballet me organet e rendit dhe drejtësisë. "U ofroj bashkëpunimin tim si ministër, organeve të rendit dhe drejtësisë për çdo informacion që kemi si institucion!", ka deklaruar ministri Peci.

Çfarë na thotë historiani legjendar, për përbuzjen ndaj klasës së sotme punëtore



Nga: Kenan MALIK /
The Guardian
Përkthimi: *Telegrafi.com*

Kur je adoleshent, rrallëherë ndodhë të pushtohesh nga një libër me 900 faqe (pos në rastet kur *Hari Poteri* është në titull). Aq më pak kur është një libër i dendur i historisë, që në detaje të sakta i tregon historitë e endësve dhe të punëtorëve të qymyrit, të këpucarëve dhe ndërtesuesve të anijeve të shekullit XVIII.

Megjithatë, edhe tash mund ta shoh veten kur për herë të parë, në një librari, u ndesha me veprën e EP Thompsonit, *Krijimi i klasës punëtore angleze* [*The Making of the English Working Class*]. Nuk e kisha asnjë ide për rëndësinë e tij kulturore apo për vendin e tij në debatet e historiografisë. Nuk e dija çfarë do të thotë “historiografi”, madje as që ekzistonte diçka e tillë. Por, ende mund ta ndiej emocionin kur librin e hapa dhe e lexova paragrafin e parë: “Klasa punëtore nuk u ngrit si dielli në një kohë të caktuar. Ishte e pranishme në krijimin e vet”. Nuk e dija se si është e mundur të shkruash për historinë në atë mënyrë.

E kam ende atë botimin e vjetër të dëmtuar të [shtëpisë botuese] *Pelican-it*, me nënvizimet me laps, me grafikën e George Walkerit të një minatori të Jorkshirit në kopertinë; një libër tek i cili vazhdoj të zhytem, thjesht për kënaqësinë e prozës së Thompsonit dhe sepse çdo lexim ofron një pasqyrë të re.

Nëse Thompsoni do të ishte ende gjallë, të shtunën do t'i kishte mbushur 100 vjet. Rasti u shënu

me një [konferencë të vogël](#) në Halifaks, në qytetin ku Thompsoni jetoi për shumë vjet – tekta jepte mësim në Lids dhe shkruante librin e vet. Por, përtej kësaj ka pasur pak bujë.

Edhe sot i ribotuar – më shumë se 60 vjet pasi u botua për herë të parë – *Krijimi i klasës punëtore angleze* ka fituar statusin pothuajse mitik. Megjithatë, vetë Thompsoni u zbeh nga horizonti ynë kulturor. Para një dekade, historiani Robert Colls vuri dukje se kur në vitin 2013 [moderatori] [Jeremy Paxman pyet](#) – në gjysmëfinalen e [kuizit televiziv] *Sfida e Universiteteve* [*University Challenge*] – se “kush e shkroi *Krijimin e klasës punëtore angleze*?”, këtë “askush nuk e dinte”. Vepra më me ndikim e Thompsonit u shkrua në valën e lartë të ndikimit të klasës punëtore në politikën britanike. Sot, klasa e vjetër punëtore industriale, për krijimin e së cilës shkroi Thompsoni, është kryesisht e pabërë, politikisht e marginalizuar dhe e zhveshur nga fuqia shoqërore. Pakkush e konsideron klasën si koncept pjellor në mendimin historik, edhe më pak si bazë për politikën progresive.

Megjithatë, argumentet e tij i bëjnë gjithashtu domethënëse vetë ndryshimet që kanë çuar në neglizhencën e tashme të Thompsonit. Në zemër të librit të Thompsoni është një riparamendim i klasës dhe vetëdijes klasore. Klasa, shkruante ai, ishte “jo një send” apo një “strukturë”, por një “dukuri historike” përmes së cilës të shpronësuarit, “si rezultat i përvojave të përgjithshme (të trashëguara apo të përbashkëta),

ndejnë dhe artikulojnë identitetin e interesave të tyre si mes vete ashtu edhe kundrejt njerëzve të tjerë interesat e të cilëve janë më ndryshe (dhe zakonisht të kundërta) prej tyre”.

Thompsoni argumentonte kundër pikëpamjes konservatore të marrëdhënieve klasore që përshkruhen si “bashkëjetesë harmonike e grupeve që kryejnë role të ndryshme shoqërore” dhe kundër një forme të determinizmit ekonomik që paramendon – siç e tha ai më vonë në një intervistë – se “një lloj i papërpunuar materiali, si fshatarët që ‘dynden në fabrika”, mund të “përpunohet në kaq shumë tabore të proletarëve të ndërgjegjshëm për klasën”. Për Thompsonin, klasa punëtore “e bëri veten për aq sa ishte e bërë”. Kjo ide e lirisë së veprimit, e njerëzve – edhe në rrethanat më të pafavorshme – që zotëronin aftësitë për të ndikuar në botë, ishte qendrore në veprën e tij kryesore jetësore.

Thompsoni ishte marksist, anëtar i Partisë Komuniste nga e cila u largua me neveri më 1956 – pas shtypjes sovjetike të revolucionit hungarez – dhe ndihmoi në themelimin e të Majtës së Re. Megjithatë, marksizmi i tij u mbryjt nga dy tradita të tjera, ajo e protestantizmit radikal, nga [lëvizjet fshatare] *Niveluesit* [*Levelers*] dhe *Gërmuesit* [*Diggers*] e shekullit XVII, e deri te disidentët e mëvonshëm, nga kuakerët dhe baptistët [lëvizje të krishtera], si dhe nga romantizmi i artikuluar më së miri nga William Blake – nga subjekti i librit të fundit të Thompsonit, [që u botua](#) pas vdekjes së tij. Ky marksizëm kundërshtues, romantik, është

ngulitur thellë në studimin historik të Thompsonit, në debatet e tij të polemikave dhe në aktivitetin e tij politik.

Rreshti më i famshëm nga *Krijimi i klasës punëtore angleze* është pohimi i Thompsonit “për të shpëtuar tjerësin e varfër, prerësin ludit [që kundërshtonte teknologjinë], endësin e ‘vjetruar’ të tezgjahut, artizanin ‘utopik’” nga “mospërfillja e madhe e pasardhësve”. Ajo që ai donte të thoshte ishte se nga këndvështrimi ynë, lëvizjet si ajo ludite – e punëtorëve të tekstilit të cilët në fillim të shekullit XIX kundërshtuan futjen e makinerive të reja dhe i shkatërruan ato – mund të duken të prapambetura dhe të paarsyeshme, si kundërshtim i pakuptimtë ndaj inovacionit teknologjik. Megjithatë, lufta e tyre, në sytë e Thompsonit, nuk ishte “opozitë e verbër ndaj makinerisë”, por më tepër ishte një luftë kundër “lirisë” së kapitalistit për të shkatërruar zakonet e tregtisë, qoftë nga makineritë e reja, nga sistemi i fabrikës apo nga ... ulja e madhe e pagave.

Ndoshta të gjitha këto tema sot janë edhe më të rëndësishme sesa në kohën kur Thompsoni e shkroi librin e vet. Kuptimi i tij i klasës jo si një gjë, por si një marrëdhënie, dhe jo si e dhënë, por e krijuar nga lufta, është po aq kuptimplotë për këtë epokë post-industriale sa ishte edhe në analizën për ardhjen e industrializimit.

Ndjeshmëria e Thompsonit për ata që detyrohen të luftojnë në një terren jomikpritës shoqëror, ofron mësim edhe për ne sot. Sot çështja është te përbuzja e madhe jo nga ana e pasardhësve, por nga të

tashmit: përbuzja për njerëzit e klasës punëtore, armiqësia për të përfutur nga “ndihma”, tallja ndaj atyre që detyrohen të përdorin bankat ushqimore [ushqimi falas për nevojtarët], indiferenca ndaj padrejtësisë. Është e dukshme edhe në përbuzjen e fanatizmit dhe konservatorizmit të supozuar të klasës punëtore ose në përçmimin e atyre që votuan rrugën e gabuar ose që janë zhgënjyer nga e majta. Këmbëngulja e Thompsonit se “aspiratat e tyre ishin të vlefshme për sa i përket përvojave të tyre” është po aq e nevojshme për t'u pranuar tani sa edhe atëherë.

Ka, siç kanë theksuar kritikët, vrima në narrativën e Thompsonit. Gratë kryesisht mungojnë te *Krijimi i klasës punëtore angleze*, siç ndodhë më gjerë në botë, veçanërisht ndikimi i skllavërisë dhe kolonializmit në ndërgjegjen e klasës, gjë që është e çuditshme kur merret parasysh ndikimi i radikalëve të klasës punëtore në lëvizjen abolicioniste [eliminimin e skllavërisë]. Ka raste, gjithashtu, kur romantizmi i Thompsonit në mënyrë të pakëndshme i afrohet dëshpërimit për modernitetin.

Megjithatë, përkundër kritikave, *Krijimi i klasës punëtore angleze* nuk është veçse një vepër madhështore e gërmimeve historike, por edhe nderim i vlefshëm për shpirtin njerëzor, për aftësitë e njerëzve për të kapërcyer rrethanat dhe kolektivisht për ta përfytyruar një botë më të mirë. “Arti i së mundshmes”, [siç shkroi Thompsoni](#), “mund të frenohet nga përfshirja e gjithë universit vetëm nëse e pamundura mund të gjejë mënyrat për t'u kthyer përsëri në politikë – përsëri dhe përsëri”.

/Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Berisha paraqitet te Petrolul Ploiesti; Gripshi, afër marrëveshjes me Cracovian

Rrugën e Meriton Korenicës, Albion Rrahmanit, Ermal Krasniqit dhe Qëndrim Zybës e ka ndjekur edhe sulmuesi Albin Berisha që ka nënshkruar kontratë me skuadrën e Petrolul Ploiestit. Shumë shpejt këtë rrugë mund ta ndjekë edhe mesfushori Nazmi Grpishi, që është afër marrëveshjes me Cracovian



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 SHKURT - Skuadra e Ballkanit, përveç rezultateve të mira në dy vitet e fundit në rrafshin vendor dhe në atë ndërkombëtar, po arrin që futbollistët e saj t'i shndërrojë në yje që po kërkohen e transferohen në ligat evropiane. Rasti i fundit është ai i sulmuesit Albin Berisha, i cili e ka bërë hapin e madh duke u transferuar në elitën e futbollit të Rumanisë nga Superliga e Kosovës. Sulmuesi që djersiti me sukses fanellën e Ballkanit ka nënshkruar kontratë dhe është paraqitur në skuadrën e Petrolul Ploiestit. "Mirë se erdhe Albin Berisha! FC Petrolul Ploiesti ka arritur marrëveshje me FC Ballkani për transferimin e kosovarit Albin Berisha", thuhet në njoftimin e klubit rumun.

Ky klub, në paraqitjen e 23-vjeçarit, ka cekur se Berisha ka fituar dy tituj

kampion në Kosovë dhe një Superkupë. Pas zyrtarizimit të Berishës në klubin e ri ka reaguuar edhe skuadra e Ballkanit. Kampionët e elitës së Kosovës i kanë uruar shumë suksese Berishës në sfidën e re, derisa janë shprehur krenarë se po arrijnë ta ngrehin formimin e futbollistëve. "Qëndersulmuesi Albin Berisha është transferuar tek ekipi Petrolul 52 në Ploiesti të Rumanisë. Për djaloshin shembullor që dha shumë për skuadrën tonë, tani nis një etapë e re, në të cilën ne i urojmë sa më shumë suksese. FC Ballkani vazhdon të jetë adresa e formimit profesional të futbollistëve tanë, për të cilët në vazhdimësi krijojmë mundësi të reja", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Suhareka.

Pas kalimit në këtë klub, Berisha ka falënderuar Klubin e Ballkanit dhe të gjithë ata që e kanë ndihmuar që të ngrihet profesionalisht dhe të arrijë deri te ky sukses. "Falënderoj të gjithë

ata të cilët më kanë dhënë përkrahje vazhdimisht duke nisur nga presidenti Arsim Kabashi dhe pjesëtarët e tjerë të kryesisë, profesorin e nderuar kampion Ilir Daja që më ka ndihmuar shumë, të gjithë bashkëlojtarët me të cilët kam kaluar kohë tepër të bukura dhe më kanë ndihmuar jashtë mase vazhdimisht për të arritur suksese me këtë klub, më të cilin kam bërë hapat e parë. Falënderim i pamasë për tifozët 'Xhebrailat' që kanë qenë gjithmonë afër nesh", ka deklaruar Berisha.

Rrugën e largimit nga Ballkani dhe transferimit në Evropë mund ta ndjekë edhe mesfushori i dëshmuar shqiptar, Nazmi Gripshi. Për këtë të fundit interesim ka shprehur skuadra e Cracovias. Klubi në fjalë ka bërë një ofertë prej 400 mijë eurosh për fantazistin e Ballkanit. Marrëveshja mes klubeve mund të arrihet shumë shpejt dhe 26-vjeçari ta bëjë hapin e madh në karrierën e tij futbollistike.

SHKURT

Zhegrova në formacionin e javës në Francë

Edon Zhegrova është padyshim një nga lojtarët më në formë në Francë në Ligën 1. Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës shkëlqeu në ndeshjen kundër Clermontit, të cilën skuadra e tij e fitoi me rezultat 4-0. Ai dha asistim në minutën e 24-t, ndërsa në minutën e 40 vulosi sfidën. Anësori realizoi një gol spektakolar, teksa goditja e tij nga distanca nuk i la asnjë mundësi reagimi portierit kundërshtar. Falë kësaj performance ai ka arritur të bëhet pjesë e formacionit të javës në Francë, duke lënë pas emra të njohur si Kylian Mbappe dhe Marco Asensio të PSG-së. Formacioni: Mandanda, Santos, Adjei, Mawissa, Locko, Savanier, Andre, Teuma, Zhegrova, David, Ounas.

U mbajt grumbullimi i parë i Kosovës U16

Në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj të dielën është mbajtur grumbullimi i parë i hendbollistëve të Përfaqësueses U16 të Kosovës. Grumbullimi ishte testues dhe seleksionues, ndërsa interesimi ishte shumë i madh. Janë testuar 29 lojtare. Vajzat kanë shfaqur vullnet e dëshirë për punë, po ashtu kanë kuptuar që i pret rrugë e gjatë e angazhim në synimin për ngritje të nivelit. Ky ishte grumbullimi i parë i kësaj gjenerate. Lojtaret e përzgjedhura do të fillojnë stërvitjet më 19 shkurt. Prej 25 shkurtit deri më 3 mars, Përfaqësuesja U16 do të paraqitet në Kampionatin Mesdhetar në Podgoricë, e ku konkurrenca është shumë e fortë. Kryetrajnere e Përfaqësueses U16 është Valbona Hasani - Arifi. Ajo asistohet nga Mimoza Sefedini dhe Valbona Rudaku.

FFK: Ndeshja Liria - Ballkani zhvillohet më 11 shkurt

Komisioni i Garave i Superligës dhe Ligës së Parë e ka shqyrtuar vendimin e marrë më 24 janar në të cilin është vendosur që ndeshja e Superligës në mes të Lirisë dhe Ballkanit të shtyhet. Komisioni i Garave, si organ kompetent për zhvillimin e garave, pas ndryshimit të rrethanave, mori vendim që ndeshja në fjalë të zhvillohet më 11 shkurt në orën 13:00. "Shfuqizohet vendimi i datës 24.01.2024 dhe ndeshja e javës së 19-të, Albi Mall Superliga, FC Liria - FC Ballkani do të zhvillohet me datë 11.02.2024 (e diel ora 13:00)", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Guardiola: Haalandi nuk do të largohet

Trajneri Pep Guardiola ka hedhur poshtë thashethemet se Erling Haaland do të largohet nga Manchester City. "Çfarë mendoni? Që ne nuk duam që Erling të qëndrojë këtu për një dekadë? Ne e duam atë, për një kohë të gjatë në këtë klub. Ne jemi të dashuruar me të. E duam atë", ka deklaruar Guardiola.

Drejtori i Barcelonës: Kloppi trajner madhështor, herët të flasim për këtë çështje

BARCELONË, 5 SHKURT - Trajneri Xavi Hernandez do të largohet nga Barcelona në fundin e sezonit. Njësoj do të veprojë edhe Jurgen Kloppi me Liverpoolin. Në shtypin spanjoll ka filluar të qarkullojë emri

i 56-vjeçarit nga Stuttgarti si trajner i ardhshëm i skuadrës katalanase. Në lidhje me emërimin e Kloppit në stolin e Barcelonës, ka folur Deco, drejtori sportiv i kampionëve në fuqi të Spanjës. "Kloppi është


një trajner madhështor, por nuk mendoj se është momenti i duhur për të folur për këtë çështje. Kemi disa alternativa në lidhje me pasardhësin e Xavit. Do të diskutojmë më vonë rreth trajnerit

tonë të ri", u shpreh portugezi. Shumë emra përfliten, por gjermani është një ndër të pëlqyerit e tifozëve katalanas, të cilët shpresojnë që ai të jetë tekniku i ri i skuadrës së zezës.



Thomasi shkëlqen në derbi dhe shpallet MVP

PEJE, 5 SHKURT - Në javën e 20-të u përballën katërshja e madhe e basketbollit të Kosovës. Peja mundi Sigal Prishtinën në udhëtim, Trepça shënoi fitore ndaj Bashkimit po në udhëtim. Në fitoren e kampionëve të Kosovës ndaj prishtinasve, shkëlqeu Larry Thomas me 24 pikë, tetë kërcime dhe pesë asistime. Nga 24 pikë, 18 i realizoi për tri pikë, duke qenë i saktë gjashtë herë nga 11 tentime. Myreon Jones i Vëllaznimit përballë Istogut, po ashtu kishte indeksin e ndeshjes 27, me 24 pikë e pesë kërcime. Për të është hera e parë që hyn në top pesëshe. Golden Eagle Ylli shënoi fitore të vlefshme ndaj Proton Cable Prizrenit, ku u dallua Jalen Nesbitt me 22 pikë e gjashtë kërcime. Mitrovicasit shënuan fitoren e 13-të radhazi në këtë edicion, dhe të 18-tën në përgjithësi, ku u dalluan dyshja vendore Drilon Hajrizi dhe Mikailë Tmusiq. Hajrizi kishte 16 pikë e shtatë kërcime, derisa Tmusiq pikë, katër kërcime dhe dy asistime.



Top pesëshja

Larry Thomas (Peja) 24 pikë, 8 kërcime, 5 asistime, 27 indeksi
Myreon Jones (Vëllaznimi) 24 pikë, 5 kërcime, / asistime, 27 indeksi
Jalen Nesbitt (Golden Eagle Ylli) 22 pikë, 6 kërcime, / asistime, 25 indeksi
Drilon Hajrizi (Trepça) 16 pikë, 7 kërcime, / asistime, 17 indeksi
Mikailë Tmusiq (Trepça) 14 pikë, 4 kërcime, 2 asistime, 15 indeksi

Bostoni komandon në Lindje



BOSTON, 5 SHKURT SHKURT - Bostoni vijon të dominojë në Konferencën e Lindjes, duke fituar me rezultat 131-91 ndaj Memphisit. Ndeshje e dominuar nga skuadra e Celticsit, ku dyshja Tatum - Porzingis realizoi 60 pikë. Zhgënjën ekipi i Milwaukeees, që

u mund me rezultat 123-108 nga Utah Jazzi, duke humbur kontaktin nga Bostoni. Antetokounmpo realizoi 33 pikë e 13 asistime, por që s'mjaftuan për Bucksin, ndërsa për Jazzin 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Kampionët e Denverit fituan me

rezultat 112-103 ndaj Portlandit, ndeshje ku u dallua Nikola Jokiqi, autor i 29 pikëve. Jashtë fushës fitojnë clippersat, që falë 25 pikëve e 11 reboundeve të Leonardos, mundën me rezultat 103-95 Miamin. Në krye të renditjes në Perëndim është dyshja Oklahoma - Minnesota, të dyja fituese. Oklahoma mundi Toronto (135-127) pas dy kohëve shtesë (5 lojtarë mbi 20 pikë), ndërsa Minnesota fitoi me rezultat 111-90 ndaj Houstonit (Edwards 32 pikë).

REZULTATET

Detroit - Orlando	99-111
Washington - Phoenix	112-140
Boston - Memphis	131-91
Charlotte - Indiana	99-115
Miami - Clippers	95-103
Minnesota - Houston	111-90
Oklahoma - Toronto	135-127
Utah Jazz - Milwaukee	123-108
Denver - Portland	112-103

Mbappe në verë shkon në Milan, Leao shihet si zëvendësues

Kýlian Mbappe në verë pritet t'i bashkohet Real Madridit, derisa PSG-ja ka filluar të mendojë për zëvendësuesin e francezit.

"Telefoot" raporton se drejtuesit e kampionëve të Francës e kanë zgjedhur yllin e Milanit, Rafael Leao, për ta pasuar Mbappen. Në

akordin e rinovimit të Leao me skuadrën e Milanit është vendosur klauzola e shitjes së tij prej 175 milionë eurosh. Gjatë

këtij edicioni, "luzitani" nuk është se ka pasur një impakt shumë të madh, me 24-vjeçari, n cili deri më tani ka arritur të

numërojë vetëm 6 gola dhe 8 asistime në 27 përballjet e zhvilluara në të gjithë kompeticionet.

SHKURT

Inzaghi: Gara për titull është e hapur

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, ka thënë se, edhe përkundër fitores në derbi kundër Juventusit, gara për titull në Serinë A vazhdon të jetë e hapur. "Interi mori një fitore të rëndësishme, super të merituar dhe jemi të lumtur për këtë. Përballë spektatorëve tanë të mrekullueshëm zhvilluam një ndeshje shumë të bukur. I bëj komplimentet e mia portierit Szczesny, ndeshjen e mbajti ai të hapur me dy pritje fantastike kundër Barellas dhe Arnautoviqit. Gjithsesi, Juve e Milani nuk do të lëshojnë asnjë centimetër. Kemi fituar 18 nga 22 ndeshje, por jemi vetëm 4 pikë plus Juve. Edhe Milani është aty", ka deklaruar Inzaghi.

Allegri: Interi është favorit për titull

Massimiliano Allegri, pas humbjes që Juventusit e pësoi nga Interi në derbi, ka thënë se skuadra "zikaltër" është favorite kryesore për "Scudetto". Tekniku italian është shprehur më pas i lumtur për formën e mirë të "Zonjës së Vjetër" në këtë edicion dhe pozitën aktuale në renditjen tabelore. "Askush nuk e priste në fillim të sezonit që të ishin në këtë pozicion, më pas mediet atë punë kanë, luajnë me këtë duel. Interi është favorit për titullin, por ky nuk është një lajm. Ne, nëse do të jemi të zotë të qëndrojmë pas tyre do të ishte mirë, por duhet të kemi kujdes edhe nga Milani. Është aty, pas nesh", ka deklaruar Allegri.

FIFA cakton stadiumin e finales së Botërorit 2026

FIFA vendosi kalendarin e Botërorit 2026, finalja e të cilit do të luhet më 19 korrik në MetLife Stadium në New Jersey Arena 82 500-vendëshe, që ka kushtuar 1.6 miliard dollarë e që është hapur më 2010 dhe ka kapacitetin më të lartë mes stadioneve amerikane që presin Kampionatin Botëror. Turneu i parë me 48 skuadra do të zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe Meksikë. Aktiviteti do të hapet më 11 qershor në stadiumin Azteca në Mexico City. Kjo arenë legjendare ka pritur më parë finalen e 1970-s dhe 1986-s. "Kupa e Botës më gjithëpërfshirëse dhe me ndikimin më të madh të të gjitha kohëve nuk është më një ëndërr, por një realitet", ka thënë presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino.

Conte i thotë 'jo' Barcelonës

Trajneri Antonio Conte është përfolur se mund të jetë pasues i Xavi Hernandezit në skuadrën e Barcelonës, por mediet iberike kanë raportuar se trajneri italian e ka refuzuar klubin katalanas. Sipas raportimeve, Conte e ka refuzuar Barcelonën për faktin se ka arritur marrëveshje me drejtuesit e Milanit për ta marrë drejtimin e klubit kuqez i në fund të këtij edicioni. Barcelona po kërkon trajner të ri, pasi Xavi ka konfirmuar largimin në përfundim të sezonit aktual.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Muharrem Morina shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, me nr. 6156/III-1987.

- Mefide Qarhaxhije (Zajmi) nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Meriton Kirolobi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Kadri Kusari".

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Nikollë Prenaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Mizajete Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës fillore "Gani Morina".

- Jehona Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme "Hajdar Dushi" Gjakova.

- HalilMala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Artan Ademaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari".

- Jehona Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Luigj Gurakuqi", Korenicë.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044\558-894 Prishtinë.

- Ylfete Spasi (Vehapi) nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

